



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E GJAKOVËS
 OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. /2026

Dt.27.02.2026

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 51 dhe nenit 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 38 dhe 40 të Statutit të Komunës së Gjakovës, nenin 6 paragrafët 7 dhe 8 të Ligjit Nr.05/L-020 për Barazi Gjimore, nenin 3, nenit 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr.05/2020, për Procedurat e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve të tjera në Komunë, si dhe rekomandimit të MAPL-së për rishqyrtim të Vendimit nr.01-011/01-1456 të datës 06.01.2026, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2026, pas diskutimit lidhur me pikën e 5 të Rendit të Ditës: Ndryshimi i Vendimit për Themelimin e Komitetit për Komunitete, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komiteti për Komunitete në Komunën e Gjakovës me këtë përbërje:
 1. z. Artan Berisha, përfaqësues i Komunitetit Egjiptian.
 2. z. Xhavit Rexhaj, përfaqësues i Komunitetit Egjiptian.
 3. znj. Floriana Dana, përfaqësues e Komunitetit Ashkali.
 4. z. Emrah Cermjani, përfaqësues i Komunitetit Rom.
 5. znj. Ifeta Jakupi, përfaqësuese e Komunitetit Boshnjak.
 6. z. Nik Hiseni, përfaqësues i Kuvendit të Komunës.
 7. znj. Fjolla Dhashi Gola, përfaqësuese e Kuvendit të Komunës.
 8. znj. Kllara Nikollbibaj, përfaqësuese e Kuvendit të Komunës.
 9. z. Kujtim Golaj, përfaqësues i Kuvendit të Komunës.
2. Kompensimi i anëtarëve të këtij komiteti që nuk janë zyrtar Publik të bëhet nga kategoria Mallra dhe Shërbime nga zyra e Kuvendit të Komunës ekuivalent me pagesën e anëtarëve tjerë që janë zyrtar Publik (anëtar të Kuvendit) në masën 30% të pagës së Anëtarëve të Kuvendit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.
4. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës, z. Ardian Gjini .
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Anëtarëve të Komitetit për Komunitete.
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës .
 - Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.
 - Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Shefqet Shehu